

Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K.

## STATUTI

### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K

Bazuar në ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare (i ndryshuar)", në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit QKB (i ndryshuar)", si dhe në "Aktin e Themelimit" të shoqërisë "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K, sot më datën 30 Gusht 2019 unë ortaku:

**Beartin Renato Koçibelli**, i lindur në *Dachau, Gjermani* dhe banues në adresën: "Ndërtesë private në, Lagje Nr.6, Rruga. Demir Progri Nr.25, Zona kadastrale Nr 8564, Korçë" me kombësi Shqiptarë dhe me shtetësi Amerikane e Shqiptare, i identifikuar me pasaportë Amerikane Nr 557791495 dhe IDI-n personal Shqiptar J20723087G, me datëlindje 23/07/1992, me kam theemeluar Shoqerinë me Përgjegjësi të Kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K.

Sot, më 30 Gusht 2019 vendosa të miratoj e të depozitoj në QKB "Dega Korçë Shqipëri". Statutin për Shoqerinë me Përgjegjësi të Kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K të cilën e kam hartuar dhe firmosur me këtë përbajtje:

## TITULLI I

### **EMËRTIMI - SELIA - KOHËZGJATJA E AKTIVITETIT DHE OBJEKTI**

Neni 1

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar emëtohet me emrin "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K., me këtë Statut në përputhje me Aktin e Themelimit të shoqërisë "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K., bazuar në "Legjislacionin Shqiptar në fuqi", rregullon pozitën juridike të Ortakëve dhe pozitën juridike e statusin e Administratorit të shoqërisë. Me këtë Statut rregullohen të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të shoqërisë, të dhënat me rëndesi për pozitën dhe qëllimin juridik të saj, organizimi, aktiviteti financiar, objekti i veprimtarisë së shoqërisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e saj.

Neni 2 ORTAKËT DHE MJETET FINANCIARE TË THEMELIMIT TË SHOQËRISË

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K. është krijuar nga Ortaku i sipërpërmendor **Beartin Renato Koçibelli**. Burim i Kapitalit filletar të derdhur janë mijetet vetjake financiare pronë e tij, të cilat mund të shtohen gjatë vazhdimit të së aktivitetit sipas mënyrave që parashikon ligji. Kjo shoqëri tregtare merr cilesinë si "Person Juridik" me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë "Qendrës Kombëtare të Regjistrimit QKB". Shoqëria ka vulen dhe logon e saj identifikuase në formen dhe në ekstremitet e caktuara nga Asambleja e Ortakëve.

Neni 3

#### **SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria me Pergjegjësi të Kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K e ka selinë në adresën: "Ndërtesë private në, Lagje Nr.6, Rruga. Demir Progri Nr.25, Zona kadastrale Nr 8564, Korçë"

Shoqëria ka të drejtë të operojë me filiale të vetat për qëllime tregtare, promocionale e marketing në të gjithë Territorin e Republikës se Shqipërisë ose jashë vendit.



Neni 4

Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K.  
KOHËZGJATJA E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K do të jetë e pakufizuar. Ky afat mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve në pajtim më legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së Shoqerisë "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K do të jetë:

- Import dhe tregtim me shumicë dhe me pakicë online dhe në njësi të caktuara tregtara i të artikujve industrialë: -Ngritje dhe shfrytëzimi i bareve, picerive, restoranteve dhe hoteleve; - Ngritje dhe perdonim i agjensive turistike, exchange-ve dhe i agjensive publicitare;
- Shërbime të ndryshme ndaj publikut me transport brenda e jashtë vendit për udhëtarë dhe për mallra; -Ndërtimi dhe riparimi i objekteve të banirnit, i rrugëve, i objekteve sociale, i objekteve industrialë, i objekteve bujqësore dhe i veprave të arrit me karakter bujqësor, i kanalizimeve, i ujësjellësave dhe i shkarkuesve; -Investime dhe sipërmarrje për instalimin e sistemeve të ngrohjes dhe të freskimit në objekte gjatë procesit të ndërtimit ose në procesin e rikonstruksionit të tyre; -Projektime në fushën e ndërtimit të gjitha llojet e tyre dhe për të gjitha kategoritë e punimeve brenda dñe jashtë vendit; -Prodhim, import-eksporti i lëndëve të para, i mallrave industrialë dhe i mallrave të natyrave të tjera, i makinerive që i materialevë e pajisjeve ndihmëse përmontimin dhe mirëmbajtjen e tyre; -Import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe me pakicë i të gjithë artikujve ushqimore, i artikujve industrialë, i artikujve të duhanit dhe nënprodukte të tij, i artikujve të kafesë, dhe i artikujve bujqësorë;
- Veprimtari në fushën imobilare si shitje, blerje dhe dhënie me qira e pronave dhe e pasurive të paluajtshme;
- Aktivitete prodhimi, shërbimi dhe punimi në kulturat bujqësore, në kultivimin e luleve natyrale, në pyje dhe në fushën e përpunimit dhe të tregtimit të artikujve bujqësorë e blegtoralë. Të gjitha veprimtaritë e mësipërme do të realizohen nën të drejtën e importit dhe të eksportit komform kërkesave specifike të legjislacionit shqiptar për se cilën veprimtari.

**TITULLI II  
KAPITALI - INSTRUMENTET E FINANCIMIT DHE PJSËMARRJA  
NË KAPITAL**

Neni 6

DISA TË DREJTA TË SHOQËRISË

6.1 Objekti i veprimtarisë, Emërtimi, Selia e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K, Shtimi i Ortakëve dhe ato çka janë përektuar në këtë Statut mund të ndryshojnë me Vendim të Asamblesë së Ortakëve në perputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

6.2 Shoqëria tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K e ushton veprimtarinë e saj me qendër në Korçë, Shqipëri në adresën: "Ndërtesë private në, Lagje Nr.6, Rruga Demir Progri Nr.25, Zona kadastrale Nr 8564, Korçë". Shoqëria tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K mund të krijojë filiale, dege e perfaqësi brenda e jashtë vendit në perputhje me legjislacionin e seilit vend ku do të ushtroje aktivitetin duke i shfrytëzuar ato për aktivitet tregtar, për qëllime promocionale, marketingu dhe për aktivitete të tjera në varësi të kërkesave të aktivitetit tregtar duke respektuar me seriozitet gjithë legjislacionin rregulatori Shqiptar në fuqi.



Neni 7

Statuti i shoqerise tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K.  
**QËLLIMI I AKTIVITETIT TË SHOQËRISË**

Shoqëria Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K ushtron veprimtarinë e saj për të realizuar fitimin. Gjithë aktiviteti i saj bazohet duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, të sigurisë e të rentabilitetit dhe përgjigjet për detyrimet e veta me pasurinë e saj.

Neni 8

**MJETET E SHOQËRISË**

8.1 Kapitali Themeltar i shoqërisë tregtare "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K është 100.000.00 (njëqindmijë) lekë. Sipas ligjit, Kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100.00 lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në Kapitalin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:

a). Zoti **Beartin Renato Koçibelli** është Ortak i vetëm, zotëruesi i një kuote me vlerë të përgjithshme në masën 100.000.00 (njëqindmijë) lekë, e cila përbën 100%. (njëqind përqind) të Kapitalit Themeltar të shoqërise.

8.2 Ky Kapital në masën 100%, në vlerën 100.000.00 (njëqindmijë) lekë do të jetë i derdhur tëresisht në Bankë brenda 30 ditëve pas firmosjes së Statutit të Shoqërisë Tregtare "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K.

8.3 Kuotat e pjesëmarrjes në Kapital janë të ndashme në rast suksedimi për shkak vdekjeje ose tjefësimi. Në rast bashkëpronësie të një pjesëmarrjeje, të drejtat e bashkëpronarëve duhet të ushtruhen nga një përfacësues, i mandatuar, nga të gjithë të përfaqësuarit.

Neni 9

**ZMADHIMI DHE ZVOGËLI IMI I KAPITALIT**

9.1 Zmadhimi i Kapitalit

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K mund të zmadhojë Kapitalin si me anën e derdhjeve në të holla si me anën e kapitalizimit të Rezervave e të Fitimeve Neto të realizuara ashtu dhe me anën e futjes së "Aktiveve Afatgjata dhe Afatshkurtra" në Aktivet e shoqërise.

Zmadhimi i Kapitalit me anër e derdhjeve të reja mund të realizohet vetëm nepërmjet derdhjeve direkte në te holla në llogaritë e shoqërisë. Ai mund të zmadhohet nepërmjet futjes në shoqëri të kontributeve në natyrë duke respektuar rregullat e hipotekimit, të regjistrimit ose të dorëzimit komform kërkesave të Standarteve të Kontabilitetit, duke përjashtuar dorëzimet në shërbime.

Administratorit nuk i jejet e drejta të zmadhojë Kapitalin, e drejtë kjo që disponohet vetëm nga Ortakët në bazë të vendimit të "Asamblesë së Ortakëve".

9.2

**Zvogëlimi i Kapitalit**

Kapitali mund të zvogelohet në rastet dhe mënyrat e parashikuar në ligj me vendim të "Asamblesë së Ortakëve", vendim ky i marrë me mazhorancat e parashikuara për ndryshimet statutore. Në të gjitha rastet zvogëlimi i Kapitalit i prek Ortakët në të njejtën masë ndaj pjesëve të Kapitalit që përfaqësojnë.

Projekti i zvogëlimit të Kapitalit u komunikohet "Audituesve Lig orë, Ekspertë Kontabël" në rast se ka të tillë të paktën 45 ditë përpëra mbledhjes së "Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve" të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti. "Audituesit Ligjore, Ekspertë Kontabël" i bëjnë të ditur "Asamblesë së Ortakëve" vlerësimin e tyre për arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të Kapitalit.



Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBSHIP-ONLINE" SH.P.K.

Secili nga Ortakët "kur shoqëria tregtare bëhet me shumë Ortakë nga efektet e zmadhimit ose të ndarjes së kuotave" në çdo rast ka të drejtën të marrë nga shoqëria kopje për të gjitha dokumentet që lidhen me shkaqet e zvogëlimit dhe me procedurën që do të zbatohet për zvogëlimin e Kapitalit.

I gjithë informacioni bëhet i njohur për secilin Ortak në harkun kohor nga data e thirrjes deri në datën e mbledhjes së "Asamblesë së Fërgjithshme të Ortakëve", e cila merr vendim me specifika shumë të precizuara. Duke e miratuar me mazhorancat e parashikuara për ndryshimet statutore.

Neni 10

#### KONTRIBUTE DIJE FINANCIMET E ORTAKËVE

10.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBSHIP-ONLINE" SH.P.K "kur është me një Ortak ose kur bëhet me shumë Ortakë nga efektet e zmadhimit ose të ndarjes së kuotave" mund të marrë nga Ortakët, ne konsensusin parapijak të tyre, derdhi me Kapital mbi bazën e një vendimi të "Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve", duke nënshkruar me secilin nga Ortakët, mbi bazën e konsultimeve personale, financime ose kontribute në natyrë që shkaktojnë ndryshimin e raporteve në kuota për secilin Ortak në veçanti.

10.2 Gjithashtu shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBSHIP-ONLINE" SH.P.K mund të marrë fonde nga Ortakët në formë huaje ose me tjetër titull, me detyrimin e rimburimit ose të pagesës së qirasë, duke zbatuar legjispcionin shqiptar të mbledhjes së kursimeve prej Ortakëve.

Neni 11

#### NDALIMI I EMËTIMIT TË TITUJVE TË DEBISË

Shoqëria "ALBSHIP-ONLINE" SH.P.K nuk mund të emëtojë tituj debie.

Neni 12

#### TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT

12.1 Pjesët e Kapitalit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBSHIP-ONLINE" SH.P.K janë të transmetueshme me anën e një akti intervivos.

12.2 Nëse një Ortak kërkon të tjetërsojë titullin e pronësisë, te gjithin ose një pjesë të tij, do t'i takojë seilit prej Ortakëve të tjerë e drejta e parablerjes, me çmim dhe me kushtet e njëjta. Me tjetësimin do të kuptojmë transferimin e pronësisë dhe të çdo lloji të drejtë tjetër mbi koutën.

Këtu është e përfshirë e drejta e pronësisë në tërësi dhe uzufruki i pjesës së Kapitalit; E drejta e parablerjes ka për objekt blerjen e të drejtës në fjalë që ortaku ka publikuar ta tjetërsojë.

12.3 Me qëllim ushtrimin e të drejtës së parablerjes, ortaku çedues (shites) duhet të komunikojë me rjë letër rekomande "me njoftim-marrje" Ortakëve të tjerë, për kushtet e shitjes, çmimin dhe emrin e blerësit (të deklaraar të kuotave). Po i njëjti njoftim duhet njëkohësisht, të realizhet me qëllim që të vihet në dijeni Organit Administrativ me letër rekomande me "njoftim-marrje". Ortakët e tjerë duhet të shprehin vullnetin për të ushtruar të drejtën e parablerjes po me letër rekomande me "njoftim-marrje", e cila i dërgohet Ortakut brenda tre muajve nga matja e njoftimit të shitjes prej ketij të fundit. Vullneti i mësipërm duhet njëkohësisht të jetë manifestuar me qëllim të vënies në dijeni të Organit Administrativ me letër rekomande "me njoftim-marrje". E drejta e parablerjes ushtrohet për të drejtën e mesipërmë mbi të gjithe kuotën ose pjesë të saj të cilën ortaku ka ndërmend dhe e ka reklamuar ta shesë, me barazi, në çmim dhe në kushte të padiferencuara përderisa ky operacion është objekt i propozimit të formuluar nga ortaku ofertues. Nëse më shumë se një ortak do të ushtrojë të drejtën e parablerjes, këta të fundit mund të bëhen blerës të kuotave të ofruara për shitje në proporcione me sasinë e kuotave të zëtëruara nga secili prej tyre.



Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K.

12.4 Në rast se transferimi i pjesëve do të kryhet duke mos zbatuar atë që është sipërshtenuar, blerësi nuk do të ketë të crijëtë të shënohet në llojin e Ortakëve, nuk do të legitimohet në rast votimi dhe në të tjerë të drejta administrimi dhe pasurore dhe nuk mund të tjetersojë pjesën e tij të Kapitalit me efekt për shoqërinë.

12.5 Ndryshimi i pjesëmarrjes në Kapital do të jetë i mundur pa mbikqyrjen e formaliteteve të mëposhtme nëqoflëse Ortaku (që ka kërkuar ndryshimet) ka përfituar tërheqjen nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes për këtë ndryshim specifik nga ana e të gjithë Ortakëve të tjerë.

12.6 Ortakët që nuk manifestojnë vu.lne:in për blerje në terma dhe me mbikqyrjen e formaliteteve të siperpërmendura do të thotë se heqin dorë nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes. Kuta ndërkohe mund t'i transferohet blerësit te treguar në deklaratë ose Ortakëve që kanë ushtruar normalisht kërkesën për parablerje.

12.7 Transferimi i kuotave dhe regjistrimi i tyre duhet të kryhet brenda tre muajve nga skadencë e termave për ushtrimin e parablerjes. Kalimi i afatit pa ardhjen e njoftimeve të dorëheqjes nga parablerja do të bëjë të nevojshme të procedohet me një deklaratë notariale.

12.8 Pjesëmarrjet janë të transferueshme pa objeksjonet e formaliteteve të lartpërmendura pa ju takuar Ortakëve e drejta e parablerjes, në rastin kur ndryshimi bëhet në favor të bashkëshortit të një Ortaku ose të afërmve të një Ortaku në çfarëdo mënyre.

#### Neni 13 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TRASHËGIMTARËT OSE TEK ANËTARËT E FAMILJES

Kuotat e Kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje mes bashkëshorteve.

#### Neni 14 VOTAT E ORTAKËVE, LARGIMI I ORTAKUT, PËRJASHTIMI I ORTAKUT DHE PASOJAT QË SHKAKTOHEN NGA KËTO VEPRIME

14.1 Ne përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep Ortakut (në rastin kur është indivic) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose Ortakut (në rastin kur është Person Juridik), i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

14.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

14.3 Çdo kundërshtim në kohë përi cilësinë e një votuesi do t'i komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrrë do të janë të vlefshme.

14.4 Përfaqësuesi do të emërohet nga Ortaku sipas formës së parashikuar nga ligji (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratorët):

14.5 Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitollet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjeter brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktchet në njoftimin për mbledhjen e "Asamblesë së Përgjithshme".



Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K. "Ortakëve" cse në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e "Asamblesë së Përgjithshme". Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

14.6 Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*e-mail*) sipas përcaktimave të pikës 3 të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes së "Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve" ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

14.7 Ortaku mund të largonet nga shoqëria nëse Ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm te tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

14.8 Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.

14.9 Administratorët (*në rast se ka më shumë se një Administrator*) duhet të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij nenit, për të vendosur nëse Ortakut do t'i likujdohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

14.10 Ortaku ka të drejtë të ngrëjë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likujdimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit "Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Tregtare" nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likujdimin e kuotës.

14.11 Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpérblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer të bazë ië shkaqeve të paarsyeshme.

14.12 Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose Ortakëve të jerë që shkaktuara largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpérblimin e dëmit të pësuar.

14.13 Në bazë të një vendimi të zakonshëm, "Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë" mund t'i kërkojë Gjykatës përjashtimin e Ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të Statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e Ortakut, sipas pikës 1 të këtij nenit, por pa u kufizuar në to, rastet kur Ortaku:

- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme Shoqërisë ose Ortakëve të tjerë;
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel Statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis Shoqërisë Tregtare dhe Ortakut;
- c) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të Shoqërisë.

14.14 Gjatë procedurës së përjashtimit të Ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së Ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së Shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.



Statuti i shoqënsë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K.

14.15 Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë Ortakut të përjashtuar shpérblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

14.16 Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpérblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

14.17 Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likujdimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shikje të arsyeshme, por nëse shoqëria ndaj tij padi për shpérblim dëmi, Ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likujdimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

14.18 Të gjitha të drejtat, qe rrjedhin nga cilësia e Ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të Gjykatës për largimin ose përjashtimin.

14.19 Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e Ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar Ortakun.

14.20 Gjykata kompetente e shqyrtimit të mosmarrëveshjeve tregtare midis Shoqërisë tregtare dhe Ortakëve është Gjykata e trethit gjyqësor ku shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K ka selinë e saj qëndrore.

### **TITULLI III** **VENDIMET E ORTAKËVE**

15.1 Të drejtat dhe detyrimet

1. "Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve" të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e Statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e Administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e Likuiduesve dhe të "Audituesve Ligjorë, Ekspertëve Kontabël të Autorizuar";
- d) përcaktimin e shpérblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, përfshirë përgatitjen e Pasqyrave Financiare vjetore dhe të Raporteve të ecurisë se veprimitarisë;
- e) miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore dhe të Raporteve të ecurisë se veprimitarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e Kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në prcedimet e tjera ndaj Administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mëledhjeve të Asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga Ligji apo Statuti.
- j) shpérndarjen e Fitimeve.

15.2 "Asambleja e Përgjithshme" merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "c" të pikës rjë të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatëse.

15.3 Nëse shoqëria tregtare zotërohet nga një Ortak, të drejtat dhe detyrimet e "Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve" ushtrohen nga Ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i



Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjës, të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K., vetëm regjistroën në një Regjistër të Vendimeve, të dhënat e të cilat nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore dhe të Raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpëmdarjen e Fitimeve vjetore dhe mbulimir e Humbjeve;
- c) vendimet për investime;
- c) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mës kishte pasur dijeni për të.

15.4 Çdo Ortak i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet e Ortakëve dhe vota e tij ka vlerë në proporcione pjesëmarrjen e tij në Kapitalin e shoqërisë.

#### Neni 16

#### ASAMBLEJA E ORTAKEVE

##### 16.1 Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve dhe mënyrat e komunikimit

- a) "Asambleja e Ortakëve" e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K mund të mbledhet pranë selisë së shoqërisë ose në një tjeter vend, me kusht që ky të ndodhet brenda territorit shqiptar.
- b) Njoftimi për mbledhje i "Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve" kryhet me anën e letrave rekamande të dërguara ndaj Ortakëve të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së mbledhjes. Letrat dërgohet rekamande me përgjigje në vendbanimin që rezulton në Librat e Ortakëve;
- c) Në rast të fundit njoftimi duhet të dërgohet në numrin e Telefonit të Fax-it ose me E-mail që rezulton në Librat e Ortakëve;
- d) Në njoftimin e mbledhjes duhet të parashikohet dita, venci, ora e mbledhjes dhe çështjet e ditës për tu trajtuar. Kopje e njoftimit të bërë dorazi, e firmosur nga marrësi dhe elementë të tjera lidhur me vërtetimin e marrjes të të gjithë dokumentacionit, duhet të ruhen nga shoqëria në arkivën e saj. Kur njoftimi për mbledhje dhe komfirmimi i marrjes së tij nga secili Ortak realizohen me Fax ose me E-mail të dhënat ruhen sipas rregullave dhe procedurave ligjore rigorozisht të përcaktuara.

##### 16.2 Telekomunikimi

Pjesëmarrja në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K mund të kryhet edhe me anën e mjeteve të telekomunikimit, me kusht që pjesëmarrësit të mund të identifikohej dhe ata të kenë mundësi të dëgjojnë debatet, të marrin apo transmetojnë dokumente, të ndërrhyjnë kur dëshirojnë në çdo rast dhe në kohë reale në të gjitha çështjet që diskutohen duke diskutuar në debate për secilën nga çështjet që analizohen në mbledhje.

##### 16.3 Delegimi

- a). Ortaku mund të përfaqësohet në Asamble nga persona të veçantë të pajisur me prokurë të posaçme dhe dokumentacioni lidhur me të ruhet nga shoqëria. Prokura nuk mund të lëshohet me emrin e përfaqësuesit në të bardhë.
- b). Përfaqësuesi mund të zëvendësohet vetëm me atë procedurë që saktësisht në mënyrë eksplikite eshte treguar në prokurë. Ai mund të jetë qofte dhe jo Ortak.



Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBSHIP-ONLINE" SH.P.K.

- c). Nëse prokura jepet vetem për një Asamble ka efekt edhe për mbledhjet e tjera të po të rjëjtës Asamble.
- d). Pranohet edhe prokura e përgjithshme e vlefshme për disa mbledhje Asambleje, pavarësisht nga çështjet e dijes. Përfacësimi nuk mund t'i jepet as Administratorëve, as "Audituesve apo Kontrolluesve të Brendshëm" nëse ka të tillë të emeruar, as punonjësve të shoqërisë, as shoqërive të zotëruara nga shoqëria mëmë, apo anetarëve të organeve të administritimit, të kontrollit apo punonjësve të tyre.

#### 16.4

#### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, "Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve" mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë Ortakët me të drejtë votë, që zoterojnë më shumë se 30 përqind të kuotave, me përjashtim të rasteve kur Statuti parashikon një shumicë më të lartë, "Asambleja e Përgjithshme" vendos me 3/4 (tri i katërtat) e votave të Ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e Kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e Fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në Statut, për çështjet e tjera të rencitura në nenin 81 të këtij ligji, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të Ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëri e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi Ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në Statut, kushtëzohet nga miratimi i Ortakut përkatës.

Asambleja merr vendime me votën pro të Ortakëve që përfaqësojnë shumicën e thjeshtë të votave të Ortakëve të pranishëm me përjashtim të vendimeve të parashikuara në pikat b), e), g), i) të nenit 15.1, për të cilat është e nevojshme votimi pro i ortakëve që përfaqësojnë të paktën 3/4 e Kapitalit të shoqërisë. Për slikarkuinin e Administratorit mund të zbatohen rregullat e përcaktuara në nenin 95.6 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Asambleja drejtohet nga Administratori i vetëm ose nga "Presidenti i Këshillit Administrativ", ose ne rast të disa Administratorëve me kompetenca të bashkuara apo të ndara, edhe në këto raste drejtimi bëhet nga Administratori më i vjetër dhe në mungese të personit të parashikuar nga pasuesi.

Asambleja mund të emerojë një sekretar qoftë edhe jo Ortak dhe sipas nevojes vëzhgues qoftë dhe jo Ortak.

Presidenti i "Asamblesë së Ortakëve" verifikon rregullsinë e situatës, vërteton identitetin dhe legjitimimin e të pranishmëve, rregullon zhvillimin e Asambleje dhe verteton rezultatet e votimit. Për zbatueshmërinë e këtyre proceseve duhet të bëhet vërtetim në procesverbalin e nënshkruar nga Presidenti dhe nga Sekretari (nëse ka të emëruar) ose nga Noteri nëse kerkohet nga ligji.

Prosesverbal duhet të redaktohet merjehërë nën kujdesin e Presidentit, ose në rastet e parashikuara nga ligji, nga Administratorët apo nga Notezi.

#### 16.5

#### Asambleja totalitare

Në mungesë të komunikimit (njëstimit) formal, Asambleja cilësohet si e mbledhur rregullisht, nëse në të marrin pjesë përfaqësuesit e të gjithë Kapitalit të shoqërisë dhe të gjithë Administratorët dhe Ekspertët (nëse ka të emëruar), qofshin të pranishëm apo të njoftuar dhe asnjëri të mos dalë kundër trajtimit të çështjes.



Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K.

Nëse Administratorët apo Ekspertët (nëse ka te emëruar), nuk marrin pjesë personalisht në Asamble, duhet të lëshojnë një deklaratë të posaçme me shkrim, e cila ruhet në aktet e shoqërisë, në të cilën duhet të deklarojnë që kanë dijeni për të gjitha çështjet e ditës dhe që nuk dalin kundër trajtimit të tyre.

## TITULLI IV ADMINISTRIMI DHE KONTROLI

Neni 17

### ADMINISTRIMI

17.1 Administratorët kanë të gjitha kompetencat për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëmu i shoqërisë për realizimin e objektit të shoqërisë, përashto këtu kompetencat e atribuara vendimeve të "Asamblesë së Ortakëve" në bazë të ligjit, Statutit dhe limiteve të përcaktuara nga Akti i Emëritit.

17.2 *Emërimi i Administratorëve është në kompetencë të "Asamblesë së Ortakëve me jo më pak se 3/4 e votave të vlefshme".*

17.3 Administratorët, të cilët mund të janë Ortakë dhe jo Ortakë, qëndrojnë në detyrë deri në rast revokimi ose dorëheqjeje jo me tëpër se 5 vjet me të drejtën për tu rizgjedhur. Administratorët janë subjekte të ligjeve për ndalimin e konkurrencës.

17.4 Administrimi i shoqërisë tregtarë "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K mund të realizohet:

a) Nga një Administrator i vetëm.

b) Nga disa Administratorë, nga 2 (dy) deri në 5 (pesë) sipas parashikimit të Aktit të Emëritit.

17.5 Në rast se administrimi i besohet më shumë se një personi, Ortakë, me vendimin e emëritit do të vodosin:

a) Nëse po këto persona do të formojnë një Këshill Administrimi.

b) Nëse administrimi i përket, bashkarisht apo në mënyrë të veçuar, Administratorëve për kryerjen e veprimtarisë së rregullt të shoqërisë, apo bashkarisht ose në mënyrë të veçuar për kryerjen e administrimit të jashtëzakonshëm, përashto këtu rastet ku në bazë të parashikimeve ligjore, statutore apo aktit të emëritit, Administratorët duhet të vodosin në formën e një organi kolegjial, në bazë kjo të nenit 17 "Pjesa e dyte" e po këtij Statuti.

Neni 18 ADMINISTRATORI TË DREJTAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

18.1 Administratori i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K do të jetë zoti Beartin Renato Kocibelli, i lindur në Dachau, Gjermani dhe banues në adresën: "Ndërtesë private ndodhur në zonën kadastrale Nr 8564, Lagje Nr.6, Rruga Demir Progri, Nr.25, Korçë" me kombësi Shqiptare dhe me shtetësi Amerikane e Shqiptare, i identifikuar me pasaportë Amerikane Nr 557791495 dhe IDI-n personal Shqiptar J20723087G, me datëlindje 23/07/1992 me për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë riemërimi ose rizgjedhjeje nga "Asambleja e Ortakëve të shoqërisë", i cili nuk ndalohet nga ligji, nuk ka konflikte interesit duc nuk çshët i lidhur në marrëdhënie të tjera në konceptin e personave të lidhur te cilat mund të prekin figurën e tij nga kërkkesat e nenit 13 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar)".

Detyrat konkrete që mund të kryhen prej Administratorit, të cilat janë të autorizuara nga "Asambleja e Ortakëve" të shoqërisë tregtare iki përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K konkretisht janë:



Statuti i shoqerisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K.

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqerisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga "Asambleja e Përgjithshme";
- b) Përfaqësojnë shoqerinë tregtare;
- c) Kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqerisë;
- ç) Përgatisin dhe nënshkruajnë Bilancin vjetor, Bilancin e konsoliduar dhe Raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e Fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë Asamblesë së Përgjithshme përmiratim;
- d) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e cuhur përrrethanat, që kërçenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqerisë;
- dh) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqerisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Raportojnë përparrë Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqerisë tregtare;
- ë) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut.

18.2 Në mungesë apo në pamundësi të ushtrimit të funksionit të Administratorit të shoqerisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K atë e zëvëndëson një Ortak ose një punonjës, ce caktohet nga ai vetë me shkrim ose me prokurë të posaçme.

Neni 19

## KOMPENSI I ADMINISTRATORËVE

Administratoreve u takon rimbursimi i shpenzimeve të kryera për shkak të detyrës së tyre të vërtetuara me dokumentacion të rregullt dhe të ligjshëm.

Po këtyre personave mund tu njihet në bazë të Aktit të Emërit apo me një vendim të përbashkët të Ortakëve një shpërblim vjetor në masë fikse ose me perqindje në bazë fitimi.

Me vendim të "Asamblesë së Ortakëve" mund t'ju jepet një kompensim vjetor si titull trajtimi përfond mandati në të njëjtën kohë duke kryer sigurimin e tyre përrë garantiuar dhënien e këtij kompesisë.

Neni 20

## PËRFAQËSIMI I SHOQERISE

20.1 Përfaqësimi i përgjithshëm i shoqerisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K aktiv dhe pasiv, substancial apo procedural, në rast emërimi të një Administratori të vetëm i takon Administratoret të vetëm.

Në rast emërimi të një Këshilli Administrimi, në bazë të vendimit të "Asamblesë së Ortakëve" i adoptuar me të njëjtin vendim emërimi përfaqësimi i shoqerisë bëhet nga:

- a) Presidenti nëse ka të emëruar, zv/Presidenti nëse ka të emëruar, Administratorët apo prej Administratorëve të deleguar, në limitet e kompetencave të përcaktuara nga "Asambleja e Ortakëve". Kompetencat janë përcaktuari për secilin person në Aktin e Emëritit dhe për delegimin e kompetencave.
- b) Të gjithë arëtarët e Këshillit të Administrimit në mënyrë të veçuar ose së bashku.
- c) Në rast emërimi të disa Administratorëve me kompetencia të bashkuara apo të veçuara (në kuptim të nenit 17 "pjesa e dytë"), përfaqësimi u takon gjithashtu "Administratorëve" në mënyrë të bashkuar apo të veçuar në rastin kur ata duhet të vendosin si "Organ Kolegjal".

Me vendime të posaçme, e drejta e përfaqësimit realizohet prej seçilit Administratoret në mënyrë të veçuar.



Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K.  
20.2 Akti i Emëritit mund të parashikojë kufizime në kompetencat e përfaqësimit të Administratorëve të parashikuara shprehimisht në Aktin e Emëritit.

Emërimi i drejtorëve ose përfaqësuesve është e drejtë e Organit Administrativ me qëllim që në rast se janë në detyrë më shumë se një Administrator në kuptimi të nerit 17 "pjesa e dyte", ata do të vodosin me vendime të posaçme si "Organ Kolegjial".

Për emërimin e përfaqësuesve të posaçëm vlefshen kompetencat e përcaktuara më sipër për plotësimin e aktit specifik për të cilin lëshohet prokurë.

Neni 21

#### KONTROLLI I LLOGARIVE

"Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve" të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K në kuptim të nenit të mësipërm mund të vodosë në çdo moment të emërojë një "Auditues Ligjor, Ekspert Kontabël të Regjistruar të Pavarur", duke i përcaktuar atij të drejtat, kompetencat dhe detyrat e përgjithshme dhe specifike.

Neni 22

#### BILANCI DHE TË ARDHURAT

Viti Ushtrimor hapet më datë 01 Janar dhe mbyllet më datën 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo Viti Ushtrimor, Organi Administrativ realizon hartimin e Bilancit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K sipas kërkave të ligjit dhe në përputhje të plotë me strategjinë e përcaktuara dhe me detyrat e vodosura nga "Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve".

Bilanci i aktivitetit tregtar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K duhet t'ju paraqitet ortakëve për miratim nga "Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve" brenda njëqind e njëzet ditëve nga mbyllja e vitit kalendarik ushtrimor.

Neni 23

#### NDARJA E FITIMIT (DIVIDENDI)

Vendimi nga "Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve" e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K, i cili e miraton Bilancin, përcakton edhe rregullat mbi ndarjen e fitimeve pas térheqjes së një shume jo më të vogël e 5% (pesë përqind) për Rezervën Ligjore deri sa kjo të arrijë limitin ligjor.

Fitimet do t'ju ndahen Ortakëve bazuar në kuotat e pjesemarrjes ne Kapitalin e derdhur të shoqërisë, me përashtim të ndonjë vendimi tjetër të marrë nga "Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve" që parashikon kriimin e një Fondi Rezervash të Jashtëzakonshme, ose në destinon tjetër.

Fitimet Neto mund të mbeten të pashpërndara duke i mbartur të gjitha ose një pjesë të tyre per vitin tjetër financiar.

Pas përballimit të detyrave për likuidimin e furnitorëve, taksave, tatimeve, pagave të punonjësve dhe shpenzimeve të tjera, që ka shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K, Fitimi Neto i shoqërisë i përket "Ortakëve" të shoqërisë në masën 100% për të cilin në vitin pasardhës me vëndim të posaçëm të "Asamblesë së Ortakëve" brenda gjashtë mujorit të parë përeakekohet destinacioni i përdorimit të tij.

### TITULLIV MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PËRGJEGJËSIA

Neni 24

#### MARRËDHËNIET E PUNËS

24.1 Marrëdhëniet e punës brenda shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K rregullohen në përputhje me Aktin e Themelimit, me këtë Statut dhe duke u bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Shoqëria lidh kontrata për marrjen në punë të



Statuti i shoqerisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K. punonjësve sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë dhe i trajton punonjësit duke respektuar tërësisht legjislacionin që lidhet me të drejtat e punonjësve dhe detyrimet e shoqërisë ndaj tyre duke njojur reciprokisht përgjegjësitë e ncërsjella të palëve "Punëdhënës, Punëmarrës".

**24.2** Çdo punonjës në shoqerinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K. është përgjegjës për kryerjet me profesionalizëm, dhe disiplinë të punës. Ortakë, Administratori dhe punonjësit e shoqërisë janë të detyruar të ruajnë karakterin e fshehë të dokumentacionit, të informacionit dhe burimet e tij, të njohive e të përvojës së fituar e të shkëmbyer në këtë shoqeri tregtare, të ruajnë fshëtësinë e gjendjes financiare, të depozitave e të dhëna të tjera që organi drejtues i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K i konsideron sekrete të punës.

**24.3** Të dhënat që paraqesin sekrete të punës mund tu behen të njohta personave të tjera me lejen e Administratorit të shoqërisë. Detyrimi për ruajtjen e sekretit vezhdon edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K duke qenë detyrim sipas përeaktimeve të shprehura në "Kodin e Punës së Republikës e Shqipërisë" dhe në Kontratën Individuale apo Kolektive të Punës.

## TITULLI VI

### MBYLLJA E SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### Neni 25 KUSHTET DHE PROCEDURAT E MBYLLJES SË SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**25.1** Në qoftë se humbjet e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K nuk mund të përballohen me mjetet materiale e financiare të Ortakëve atëherë hapet procedura e likujdimit. Në rast se Kapitali i çerdhur në themelimin e shoqërisë, fitimet e akumuluara më pas gjatë veprimtarisë së saj dhe fondet materiale e financiare nuk perballojnë shpenzimet, atëherë hapet "procedura e likujdimit të shoqërisë" me vendim të jashtëzakonshëm të "Asambleës së Ortakëve" cse procedura c falimentimit të saj me vendim të "Gjykatës së Qarkut" ku ndodhet selia kryesore e shoqërisë.

**25.2** Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K mund të shpërndahet me likujdimin e saj. Në rastin e likujdimit të shoqërisë emërtimi i saj do te pasohet nga shënim "Shoqëria në Likujdim e sipër". Në rast shpërndarje të shoqërisë, Administratori (Administratorët) vendosin përmënyrën e likujdimit, ndërsa "Asambleja e Ortakëve" cakton një ose disa Likujdatorë, të cilët bëjne kujdes që shoqëria të likujdojë detyrimet që ka ndaj personave të tretë.

**25.3** Kur shoqëria tregtare pushon aktivitetin e saj, pasi shlyen detyrimet që ka, pjesa e mbetur e Kapitalit dhe të ardhurat u mbeten Ortakëve sipas raportit të kontributit në Kapitalin Themeltar të shoqërisë.

**25.4** Ndajet individuale destinoohen në bazë të vendimit të jashtëzakonshëm të hartuar mbi të dhënat e raportit të likujdimit të hartuar nga "Likujdatori ose Grupi i Likujdatorëve".

**25.5** Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**ALBASHIP-ONLINE**" SH.P.K mbyllt më 31 Dhjetor të çdo vit. Blanci vjetor i shoqërisë duhet të shqyrtohet dhe miratohet nga "Asambleja e Ortakëve të shoqërisë" brenda muajit Mars të vitit pasardhës.



Statut i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K.

## TITULLI VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

### DEKLARIMI I KRIJIMIT TË SHOQËRISË

**26.1** Kjo shoqëri tregtare merr cilësinë si "Person Juridik" me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë "Qendrës Kombëtare të biznesit QKB". Ky Statut i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K nënkupton se kjo shoqëri tregtare është deklaruar e krijuar me regjistrimin e saj në "Regjistrin Tregtar".

**26.2** Më pas të dhënat e tjera të saj deklarohen në mënyrë sistematike në vazhdimësinë e aktivitetit tregtar komform kërkesave të ligjeve të veçantë dhe kështu ato janë të transferuara dhe të deklaruara në "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve QKB". Përfundimisht shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K konsiderohet e krijuar nga dita kur ajo ka fituar statusin e Personit Juridik.

**26.3** Ndryshimet në këtë Statut të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K bëhen në te njëjtën mënyrë e me të njëjtën procedurë me të cilën nxirret ky Statut duke zbatuar Dispozitat Ligjore përkatëse.

Neni 27

### ADRESAT E ORTAKËVE DIU TË ADMINISTRATORËVE

**27.1** Për qellim të kësaj marrëveshje shoqërore, të gjitha komunikimet direkte për çdo Ortak dhe për çdo Administrator do të kryhen duke përdorur adresat e secilit Ortak dhe të secilit Administrator që rezultojnë respektivisht të Libri i Regjistrimit të Ortakëve dhe të Libri i Vendimeve të Administratorëve.

**27.2** Në Librin e Ortakëve dhe në atë të Vendimeve të Administratorëve duhet të jenë respektivisht të treguara adresat e komunikimit, numri i telefonit, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike (e-mail).

**27.3** Çdo modifikim i mëvonshëm i të dhënave të adresës kryesore në kuptim të këtij nenit do të bëhet nëpërmjet njofimit me shkrim tek Administratorët, të cilët do ta pasqyrojnë në Librin e Ortakëve ose në Librin e Vendimeve të Administratorëve.

**27.4** Mbetet detyrë e çdo Ortaku dhe Administratori përgjegjësia për mungesën e komunikimit dhe përmodifikimit e nevojshme të këruara në paragafët e mësipërm të kësaj dispozite.

Neni 28

### KLAUZOLA TË KOMPROMISIT

**28.1** Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lincin ndërmjet Ortakëve, si dhe ndërmjet Ortakëve dhe shoqërisë "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K në lidhje me raportet shoqërore ose përinterpretimin dhe zbatimin e këtij Statuti dhe të vendimeve ligjërisht të nxjerra nga "organet e shoqërise", "nga ato të emëruara prej Asamblesë së Ortakëve" dhe nga Administratorët, Likujdatorët dhe Titullariët ose në raportet me ta, përsa janë shtruar për kompromis, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe kur ato nuk gjejnë zgjidhjen e pranuar, do t'i paraqiten Gjykatës në rrethin në të cilin shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K ka Selinë kryesore të saj.



Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K.  
28.2 Kur mirëkuptimi me kompromise nuk arrihet pavarësisht nga negociatat e realizuara midis palëve atëhere të gjitha mosmarrëveshjet do të zgjidhen nëpërmjet Gjykatës së Rrethit gjyqësor ku shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K ka selinë e saj.

Neni 29

#### REFERIMET

Përsa nuk është shprehimisht përcaktuar në këtë Statut, për shoqérinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBASHIP-ONLINE" SH.P.K vlejnë dispozitat e ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare (i ndryshuar)" dhe të ligjeve të posaçme të fushës së aktivitetit tregtar.

ORTAKU THEMELUES

Beartin Renato Koçibelli

*Beartin Renato Koçibelli*

*B.R.K*